



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Nr. 490 Prot
11

Tiranë, më 27. 2 2023

Lënda: Raporti vjetor mbi gjendjen e përgjithshme të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Mbrojtjen Civile për vitin 2022

Z. Niko PELESHI
MINISTËR I MBROJTJES

Tiranë

I nderuar Z. Ministër,

Në zbatim të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, pika 5, kreut III, si dhe nenit 55 të “Rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKMC-së, në nivel qendror dhe vendor”, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 881, datë 25.06.2021, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka detyrim të raportojë brenda muajit shkurt, mbi gjendjen e përgjithshme në nivel qendror në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Ky dokument përmban kryesisht informacion mbi:

- a) ecurinë, nivelin e zbatimit dhe problemet e hasura gjatë vitit, të aktiviteteve për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;
- b) investimet infrastrukturore për zvogëlimin e riskut dhe rehabilitimin/rimëkëmbjen, realizimin e objektivave të përcaktuara nga qeveria;
- c) humbjet nga fatkeqësitë;
- ç) burimet financiare dhe njerëzore të përdorura për zbatimin e politikave në fushën e mbrojtjes civile apo përballimin e operacioneve të emergjencave civile.

Në këtë kuadër, në përfundim të një viti plot sfida dhe arritje nga AKMC, por edhe nga strukturat përbërëse të sistemit të mbrojtjes civile, janë analizuar aspektet administrative, teknike dhe financiare.

Ky raport pasqyron punën e kryer gjatë vitit nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve dhe strukturave të mbrojtjes civile në funksion të parandalimit të fatkeqësive, gjendjen e përgjithshme të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, trashëgimisë kulturore, mjedisit dhe pronës.

❖ **Aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara në zbatim të ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive**

Në vitin 2022, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka iniciuar dhe kontribuar në përgatitjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, duke vazhduar plotësimin e kuadrit ligjor, me VKM si më poshtë:

1. Vendimi nr. 345, datë 26.05.2022 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”.

❖ **Referuar Raportit të konsoliduar të Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel qendror:**

Në kuadër të projektit RESEAL, Qeveria e Shqipërisë dhe UNDP, gjatë vitit 2022, vijuan punën e nisur në vitin 2021, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel kombëtar, i cili konsiston në një raport të konsoliduar të vlerësimit të riskut të fatkeqësive dhe gjashtë raporte vlerësimi tematike për gjashtë grupe rreziqesh kryesore. Aktualisht, Raporti i VRF është përcjellë për miratim në KM.

Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive mbështet Qeverinë Shqiptare në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, si dhe në forcimin e të gjithë sistemit të MRF-së në vend. Gjithashtu, ai synon të japë njohuri domethënëse rreth procesit të mëtejshëm të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet grupeve kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit të sistemit të MRF-së, si dhe të trajtojë sfidat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Pas studimeve të kryera nga ekspertët dhe pasqyrimin të të dhënave konstatohet se:

Risqet më kritike të fatkeqësive, të cilat kanë një potencial të lartë për ndikim negativ në zhvillimin e vendit, janë *përmbytjet dhe çarja e digave, rreziqet teknologjike, rreziqet biologjike, zjarret në pyje, të pasuara nga rrëshqitjet e tokës dhe tërmetet.*




Figura 1. Risqet e fatkeqësive madhore në Shqipëri. Figurë krahasuese

Krahas analizës së risqeve kryesore në vend, raporti i konsoliduar paraqet gjithashtu analizën e risqeve kumulative të fatkeqësive për çdo qark të Shqipërisë.

Ekspozimi i qarqeve ndaj risqeve të shumëfishta

të fatkeqësive /analizë krahasuese/




Figura 2. Ekspozimi i qarqeve ndaj risqeve të shumëfishta të fatkeqësive në Shqipëri

Sipas analizës krahasuese të qarqeve për risqet e paraqitura në gjashtë raportet tematike, qarqet më të ekspozuara ndaj fatkeqësive në vend përfshijnë Tiranën dhe Vlorën (risk i lartë), pasuar nga Durrësi, Elbasani, Fieri dhe Shkodra (risk mesatar në të lartë). Berati, Dibra, Korça dhe Kukësi (risk mesatar), si dhe Gjirokastra dhe Lezha (risk i ulët në mesatar) janë më pak të rrezikuara për sa i përket tetë rreziqeve kryesore.

Vendi përballlet me një nivel të konsiderueshëm kërcënimi ndaj fatkeqësive por shpeshësia dhe shkalla e kërcënimit nuk është e njëjtë në pjesë të ndryshme të territorit. Megjithatë, kur ndodh një fatkeqësi, ajo ka gjasa të rezultojë në: humbje në njerëz dhe gjënë e gjallë; dëmtim dhe shkatërrim të pronës; dëmtim të infrastrukturës dhe dëmtim të mjedisit.

Krahas rreziqeve të fatkeqësive natyrore në territorin e Shqipërisë, rritja e cenueshmërisë së komunitetit është një faktor që kontribuon ndjeshëm në riskun e përgjithshëm dhe mundësinë e fatkeqësive në vend. Tendencat në vijim në Shqipëri kontribuojnë në rritjen e cenueshmërisë, si më poshtë:

- Rritja e popullsisë dhe rrjedhimisht rritja e dendësisë së strehimit;
- Zhvendosja nga zonat rurale në ato urbane dhe presioni i urbanizimit;
- Degradimi i burimeve natyrore;
- Varfëria ekzistuese dhe rritja e numrit të njerëzve të varfër që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve;
- Masat e pamjaftueshme në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të fatkeqësive, si dhe teknikat e pamjaftueshme të parashikimit dhe parandalimit;
- Mungesa e masave strikte për kontrollin mjedisor;
- Kapacitetet e dobëta institucionale dhe burimet e pakta për përballimin e fatkeqësive masive;

- Arsimi dhe trajnimi i pamjaftueshëm i personelit të mbrojtjes civile dhe popullsisë lidhur me masat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes;
- Pjesëmarrja e ulët e komuniteteve vendore në menaxhimin e riskut të fatkeqësive.

Rekomandimet e dhëna në raportin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë fokusohen në 3 shtyllat kryesore, si më poshtë vijon:

a) Zbutja e riskut të fatkeqësive

- Zbutja e riskut të fatkeqësive duhet të jetë një komponent i një Strategjie të Integruar Kombëtare për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive. Masat e zbutjes duhet të zbatohen sipas kategorisë përkatëse dhe intensitetit të pranueshëm;

- Monitorimi është një aspekt thelbësor i zbutjes së ndikimit të mundshëm të rreziqeve të fatkeqësive. Metodot e përparuara të monitorimit dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm mundësojnë parashikime të sakta të ngjarjeve të ardhshme dhe mund të rrisin efikasitetin e masave parandaluese.

b) Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e riskut të fatkeqësive

- Hapi i parë në ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e ardhshëm të riskut të fatkeqësive në Shqipëri, duhet të jetë vazhdimi i popullimit të bazës së të dhënave DESINVENTAR dhe regjistrimi sistematik i dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë e ardhshme dhe ngjarjet e ngjashme;

- Përgatitja e metodologjisë dhe ngritja e kapaciteteve në nivel kombëtar dhe vendor për realizimin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku dhe në nivel bashkie;

- Përmirësimi dhe funksionimi i bazës së të dhënave për të gjitha fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe vendor. Identifikimi i të dhënave, aksesit në to dhe përdorimi i tyre i mëtejshëm duhet të koordinohen me grupet e interesit në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.

c) Hartimi i Strategjisë për ZRF

- Të merren në konsideratë rezultatet e vlerësimit të riskut për planifikimin e përdorimit të tokës dhe për zhvillimin e zonave të reja rezidenciale dhe industriale;

- Të ndërmerren masa për të rritur ndërgjegjësimin mbi menaxhimin e riskut të fatkeqësive të grupeve kryesore të interesit të sistemit të MRF-së në vend.

Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është një investim ekonomik në parandalimin e humbjeve ekonomike në të ardhmen dhe menaxhimi efikas i risqeve të fatkeqësive kontribuon në zhvillimin e qendrueshëm. Në nivel global, SKZRF synon të arrijë deri në vitin 2030: *“Zvogëlimin e ndjeshëm të riskut të fatkeqësive ndaj jetës, mjeteve të jetesës dhe shëndetit, si dhe ndaj aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore, të njerëzve, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve.”*

Gjatë vitit 2022, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 59, datë 29.06.2021 “Për Ngritjen dhe Funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kryerjen e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror”, janë zhvilluar 18 takime me Grupet Teknike Ndërinstitucionale të Punës (3 takime me secilin nga 6 nëngrupet teknike), një takim me Grupin Ndërinstitucional Politik të Punës si dhe takime dypalëshe me institucione qendrore publike apo subjekte të sektorit

privat.

❖ **Referuar dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë:**

Zhvillimi i strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive është një nga shtatë objektivat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015–2030. Strategjitë për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive janë guri themel i të gjitha veprimeve të formalizuara për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe vendosin drejtimin strategjik për zhvillimet e mëtejshme të sistemit kombëtar. Si e tillë, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë e Shqipërisë përcakton qëllimet dhe objektivat në periudha të ndryshme kohore, si dhe me objektiva, tregues dhe afate kohore konkrete. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive promovon vendosjen e rregullimeve funksionale për koordinimin midis të gjithë aktorëve në Shqipëri dhe përcakton fushat kritike ku kapacitetet duhet të forcohen. Strategjia përshkruan rrethanat aktuale të sistemit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri dhe statusin, potencialin dhe boshllëqet në lidhje me secilin prej risqeve që duhet të zvogëlohen nën udhëheqjen e kësaj Strategjie. Strategjia identifikon kornizën financiare të aktiviteteve të planifikuara, misionin, vizionin e qëllimet dhe përshkruan sistemin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë.

“Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë, 2023 - 2030” bazohet në raportin e vlerësimit të riskut për 6 grup-rreziqet kryesore të evidentuara, të cilat prekin territorin e Republikës së Shqipërisë. Risqet e identifikuara janë:

1. Tërmetet;
2. Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave;
3. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët;
4. Zjarret në pyje;
5. Rreziqet nga aksidentet teknologjike;
6. Sëmundjet infektive.

Në terësinë e saj “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, 2023-2030” përbëhet nga **5 objektiva strategjike specifike**.

1. Menaxhimi i risqeve ekzistuese dhe parandalimi i risqeve të reja;
2. Rritja e ndërgjegjësimit, njohurive kombëtare dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, krijimi i komuniteteve ripërtëritëse dhe të qëndrueshme me vëmendje tek njerëzit me aftësi të kufizuara, barazia gjinore dhe grupet e tjera të cenueshme;
3. Përmirësimi i kapaciteteve të përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, nxitjes së industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitjes së inovacionit;
4. Nxitja e koherencës së politikave dhe kuadrit rregullator që lidhet me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
5. Forcimi i aftësive të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë.

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë janë identifikuar gjithashtu dhe fushat në të cilat është parë nevoja për ndërhyrje me arsye përmirësimi, modernizimi dhe forcimi të kapaciteteve në sistemin e Mbrojtjes Civile.

Fushat kryesore të ndërhyrjes janë fushat të rëndësisë dhe urgjencës më të madhe për të menaxhuar riskun e nivelit më të lartë në Shqipëri. Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes përfshin një numër aktivitete të planifikuara që do të renditen, për çdo rrezik, në Planin e Veprimit që korrespondojnë me periudhën përkatëse kohore të cilat janë:

- **Menaxhimi i risqeve ekzistuese dhe parandalimi i risqeve të reja** ku përfshihen aktivitete që kontribuojnë në: kërkimin, inovacionin dhe ndërtimin e parandalimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, njohurive dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit në shërbim të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, dhe promovimin e koherencës së politikave dhe kuadrit rregullator në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
- **Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes** ku janë përfshirë aktivitete për të forcuar kapacitetet e përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, duke promovuar industrializimin gjithëpërfshirës dhe inovacionin, si dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive me synimin për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së në një periudhë të shkurtër kohore.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit, është dakordësuar dhe konfirmuar zyrtarisht në aspektin teknik dhe juridik nga të gjitha ministritë e linjës dhe strukturat e tjera qendrore të grupit të punës. Aktualisht dokumenti i Strategjisë është miratuar me VKM Nr. 94, datë 22.02.2023.

❖ Referuar hartimit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 58, datë 29.06.2021 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të punës për përgatitjen e projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”, gjatë vitit 2022, janë zhvilluar 2 takime të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, takime me 4 subjekte të sektorit privat, 5 organizata ndërkombëtare, 2 organizata joqeveritare dhe 9 institucione publike. Procesi i hartimit të dokumentit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile ka nisur në gjysmën e dytë të vitit, pasi duhet të mbështetet në dokumentet e VRF dhe të SKZRF. Ky dokument synon:

- a) Të ndihmojë parandalimin, lehtësimin, përgjigjen dhe rikuperimin nga çdo ndikim negativ si pasojë e emergjencave dhe/ose fatkeqësive që mund të prekin jetën e njerëzve, pronën, trashëgiminë kulturore, gjënë e gjallë, komunitetet dhe mjedisin;
- b) Të sigurojë kushtet për administratat publike, subjektet ekonomike dhe popullsinë për të kaluar nga kushtet normale të jetesës dhe punës, në një situatë emergjente, me humbje minimale;
- c) Të mundësojë ofrimin e burimeve shtetërore me qëllim garantimin e sigurisë publike dhe vazhdimësinë e ekonomisë kombëtare.

• Objektivat specifike:

- a) Harmonizimi me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe dhënia e informacioneve mbështetëse për të gjitha grupet e interesit me qëllim përdorimin e terminologjisë, përkufizimeve dhe koncepteve të përbashkëta;

- b) Përgatitja e një plani aktual dhe realist, i cili të jetë i përshtatshëm për të gjitha grupet e interesit;
- c) Përgatitja e një plani që do të ofrojë informacione për zvogëlimin e riskut të rreziqeve dhe mbrojtjen e popullsisë së cënueshme;
- d) Prezantimi i procedurave dhe informacioneve me qëllim koordinimin e burimeve në mënyrë të sigurt, efektive dhe efikase gjatë përgjigjes ndaj incidenteve;
- e) Dhënia e kontekstit për kalimin në fazën e rimëkëmbjes pas incidenteve dhe dhënia e ndihmës për vazhdimësinë e veprimtarisë së qeverisë, bizneseve dhe shërbimeve.

Është hartuar drafti i parë i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. Dokumenti është në raundin e parë të komenteve dhe mund të ketë ndryshime edhe në përmbajtje apo format sipas rastit dhe natyrës së komenteve/sugjerimeve. Drafti final për bashkërendim me ministrinë e linjës është parashikuar të përcillet brenda muajit Prill 2023.

❖ **Projekti Pilot “Vlerësimi i riskut në nivel vendor për gjashtë bashkitë e Qarkut Fier”, përkatësisht për Bashkitë Fier, Lushnjë, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër**

Në Ligjin nr. 45/2019, neni 9, pika 2, përcaktohet se vlerësimi i riskut kryhet në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor. Gjatë vitit 2022, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim me konsulencën e UNDP-së, ka koordinuar dhe bashkërenduar punën për hartimin e Vlerësimit të Riskut në 6 bashkitë e Qarkut Fier. Metodologjia e përdorur për kryerjen e vlerësimit të riskut në nivel bashkie dhe për VRF në nivel qendror është e njëjtë. Në pjesën e dytë të vitit, ecuria e procesit ka qenë si më poshtë vijon:

- Është zhvilluar takimi i parë me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen civile në Prefekturën e Fierit;
- Janë realizuar takime teknike në secilën bashki përgjatë muajit nëntor me qëllim ngritjen e Grupeve Teknike të Punës dhe diskutimin e metodologjisë dhe të hapave që do të ndiqen për hartimin e dokumentit të Vlerësimit të Riskut;
- Përgjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2022, janë hartuar Urdhri i Prefektit për ngritjen e sekretariatit teknik dhe gjashtë urdhrat e Kryetarëve të Bashkive për ngritjen e Grupeve Teknike të Punës;
- Përgjatë dy muajve të fundit të vitit 2022 janë realizuar 6 takime të tjera teknike ndërmjet ekipit teknik që mbulon Vlerësimin e Cënueshmërisë dhe Kapaciteteve (si pjesë e projektit) dhe përfaqësuesve nga grupi i punës në secilën bashki, si dhe një takim në Bashkinë Divjakë;
- Pranë Prefekturës Fier, në muajin Dhjetor është mbajtur takim me institucione publike dhe subjekte private, që operojnë në fushën e industrisë dhe energjitikës, transportit, furnizimit me ujë dhe mjedisit dhe ushtrojnë aktivitetet në territorin e bashkive të Qarkut Fier, me qëllim prezantimin e projektit dhe kërkesave për informacion;
- Në datë 20.12.2022, janë përcjellë gjashtë draftet e para të dokumenteve të Vlerësimit të Riskut për secilën bashki dhe Raporti i vlerësimit të cënueshmërisë dhe kapaciteteve.

Pas përfundimit të hartimit të dokumenteve të Vlerësimit të Riskut për 6 bashkitë, do të vijojë puna për hartimin e dokumentit të Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel Qarku Fieri, i cili do të bazohet në gjetjet e 6 raporteve në nivel bashkie. Ky proces do të ndiqet nga hartimi i strategjive

dhe i planeve vendore, në zbatim të ligjit 45/2019, neni 11, sipas të cilit çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, të harmonizuara me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planin Kombëtar të EC.

Në përfundim të këtij projekti pilot, Agjencia Komëtare e Mbrojtjes Civile do të prezantojë në 11 qarqet e tjera me bashkitë e tyre metodologjinë e zhvillimit, me qëllim që të përmbushin detyrimet ligjore të sipërpërmendura, si dhe ato në nivel qendror.

❖ **Referuar përgjegjësiave të ministrive dhe institucioneve qendrore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore; Qasja dhe masat e marra.**

Pasqyrimi i të dhënave aktuale të ministrive dhe institucioneve qendrore mbi gjendjen e përgjithshme të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, bazohet në ligjin nr. 45/2019, neni 22 aktivitetet për rritjen e kapaciteteve dhe pozicionet e punës apo sektorët e krijuar për mbrojtjen civile, në zbatimin të VKM nr. 431, datë 15.7.2021 “Për përbërjen dhe detyrat e njësisë organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministrinë e linjës”, Investimet infrastrukturore për zvogëlimin e riskut dhe rehabilitimin/rimëkëmbjen, Planet e emergjencave civile sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, Buxhetin e planifikuar dhe të realizuar gjatë vitit 2022, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile për ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, arsimin, mjedisin dhe kulturën.

1. Investimet infrastrukturore për zvogëlimin e riskut dhe rehabilitimin/rimëkëmbjen

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kryer investime infrastrukturore apo projekte për zvogëlimin e riskut dhe rehabilitimin/rimëkëmbjen.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të zbatimit të programit të investimeve për vitin 2022 ka financuar përmirësimin e infrastrukturës fizike për objekte të shërbimit shëndetësor parësor (QSH/Ambulanca) dhe të shërbimit shëndetësor spitalor.

Ministria e Arsimit dhe Sportit: Fondet e investimeve në kuadër të rindërtimit të objekteve arsimore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, për periudhën 2020-2022 janë administruar dhe menaxhuar nga Ministri i Shtetit për Rindërtim.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Referuar fushës së saj të përgjegjësisë për operimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesor kullues, hidrovorëve dhe argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave rurale, ka ndërmarrë një sërë masash, dhe konkretisht për vitin 2022:

- Në kullimin e tokave bujqësore

Nëpërmjet 4 drejtorive rajonale të ujitjes dhe të kullimit, si proces ciklik vjetor, është mundur largimi i rreth 1.8 milionë m³ dhera, duke pastruar rreth 250 km kanale kryesor kullues dhe kanale të ujërave të larta, kryesisht në ultësirën perëndimore në Bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Divjakë, Fier dhe Vlorë.

- Në kullimin e tokave bujqësore me ngritje mekanike (hidrovorë)

Gjatë periudhës së thatë (qershor-gusht 2022), është punuar për kryerjen e remonteve vjetore të 27 hidrovorëve, që kullojnë rreth 70000 ha tokë bujqësore të ultësirës perëndimore dhe gjatë periudhave me reshje të vitit 2022, këto hidrovorë kanë garantuar një funksionim të qëndrueshëm.

Ndërsa me investimet, janë financuar 4 hidrovorë me vlerë 248 milionë lekë, nga të cilët 2 kanë përfunduar, ndërsa 2 përfundojnë në vitin 2023.

Në 2 hidrovorë Balldre në Lezhë dhe Drojë në Kurbin, kanë përfunduar punimet që kanë të bëjnë me rikonstruksionin e godinave të këtyre hidrovorëve.

Gjatë vitit 2022 kanë filluar punimet për rikonstruksionin e plotë të hidrovorit të Karavastasë që kullon rreth 7000 ha në Bashkitë Divjakë e Lushnjë dhe hidrovorit të Akërnisë në Vlorë, që kullon 4600 ha (ku dhe po ndërtohet Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës), punime të cilat parashikohet të përfundojnë gjatë vitit 2023.

- Në mbrojtjen nga përmbytja

Përsa i përket ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmbytja, me investimet e vitit 2022, sqarojmë si më poshtë:

· Janë financuar 24 objekte, me vlerë 611 milionë lekë, nga të cilët 13 kanë përfunduar, ndërsa 11 përfundojnë në vitin 2023.

· Me këto investime është mundësuar rehabilitimi/ndërtimi i rreth 15 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, më të ekspozuara nga rreziku i përmbytjeve lumore, kryesisht në lumin Buna në Bahçallëk, Dajç dhe Daragjat, në lumin Kir në fshatin Bardhaj, në Bashkinë Shkodër, në lumin Osum në Uznovë, Arrëz dhe Gegë, në Bashkitë Berat dhe Kuçovë, në lumin Vjosa në Bishan, Kafaraj dhe Selenicë, në Bashkitë Vlorë, Fier dhe Selenicë, në lumin Shkumbin, në Muriqan dhe Elbasan, në Bashkitë Cërrik dhe Elbasan, në lumin Fan, në fshatin Rreth i Epërm, në Bashkinë Mirditë etj.

2. Buxheti i planifikuar dhe i realizuar gjatë 2022, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile (sipas detyrimit 2% deri në 4% të totalit të buxhetit vjetor)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: MFE ka planifikuar buxhet vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në masën 2% të totalit të buxhetit vjetor, por që nuk është realizuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjatë vitit 2022 ka planifikuar një buxhet prej 2% të buxhetit total për shpenzime operative për emergjencat që mund të ndodhnin gjatë vitit. Nisur nga fakti që gjatë vitit 2022 nuk ka pasur problematika në fund të vitit ky buxhet është shfrytëzuar për të përballuar nevojat e institucionit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit: Në MAS për vitin 2022 nuk janë miratuar fonde në kuadër të Emergjencave Civile.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Hartimi dhe planifikimi i fondeve për emergjencat civile, në masën 2% të shumës së shpenzimeve në secilin program, në projekt-buxhetin vjetor dhe afatmesëm është kërkuar të bëhet për periudhën 2023-2025, duke qenë se fazat e planifikimit për

vitin 2022 ishin mbyllur. Megjithatë vetëm 2 programe arritën gjatë fazës së detajimit të fondeve për vitin 2022, të parashikonin një zë të veçantë në artikullin buxhetor 602 "Shpenzime Korrente", Kapitull 1 "Çelje nga Buxheti", "Fondi i Dedikuar për Emergjencë". Duke qenë se nuk pati kërkesa për përdorimin e tij, gjatë vitit 2022, fondi i çelur u rialokua për mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Instituti i Shëndetit Publik: ISHP nuk ka kryer shpenzime buxhetore mbi aktivitetet për emergjencat civile gjatë vitit 2022.

3. Zbatimi i VKM-së nr. 431, datë 15.07.2022 "Për përbërjen dhe detyrat e njësisë organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministrinë e linjës"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Në zbatim të VKM 431, datë 15.7.2021, "Për përbërjen dhe detyrat e njësisë organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile", referuar përshkrimeve të punës të strukturës së Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 140, datë 26.08.2022 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë", është parashikuar një pozicion Specialisti, pranë Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: MSHMS referuar VKM-së Nr. 609 të datës 20.10.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", si dhe në zbatim të VKM 431, datë 15.7.2021, "Për përbërjen dhe detyrat e njësisë organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile" ka raportuar mbi strukturën dhe personin e kontaktit të angazhuar me mbrojtjen civile në MSHMS, konkretisht në sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Emergjencave Civile, një pozicion Specialisti për emergjencat civile.

Ministria e Arsimit dhe Sportit: Është krijuar sektori i Emergjencave Civile në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe të organogramës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit".

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Në MBZHR, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në funksion të mbrojtjes civile është krijuar Sektori i Emergjencave Civile me përbërje 2 specialistë. Sektori i Emergjencave Civile ushtron funksionet dhe detyrat e përcaktuara në Ligjin 45/2019 " Për mbrojtjen Civile" dhe akteve ligjore në zbatim të tij.

- Mban kontakte me AKMC dhe ZOS;
- Me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, përcjell informacion mbi situatën pranë AKMC dhe ZOS;
- Informacionet e marra nga AKMC i bën të njohura për titullarët e Ministrisë dhe drejtoritë përkatëse.

4. Hartimi i Planeve të Emergjencave Civile sipas fushave të përgjegjësisë dhe dokumenteve të tjera strategjike

Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Në zbatim të ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ka të miratuar:

- a- Plan masash për emergjencat civile
- b- Ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: MSHMS e përfaqësuar në Grupin Ndërinstitucional të punës ka marrë pjesë në dy takime të organizuara nga AKMC për hartimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile duke plotësuar dhe formularin e pyetësorit të dërguar për këtë qëllim. Në këtë kuadër duke u mbështetur në asistencën e AKMC-së do të hartojë planet e emergjencave civile sipas fushës së përgjegjësisë.

- Në bashkëpunim me OBSH-në është hartuar Udhëzuesi për përgatitjen e përgjigjes së spitalit ndaj fatkeqësive, janë hartuar manuale përmbledhëse mbi hapat kryesorë që duhet të ndiqen në rast të emergjencave/fatkeqësive të mundshme për përdorim nga Strukturat e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Spitaleve.

Ministria e Arsimit dhe Sportit: Në MAS është krijuar sektori i Emergjencave Civile në 03.03.2022 i cili së bashku me përfaqësuesit e MAS (Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm MAS nr. 153/1, datë 13.04.2022 “Për ndryshim përfaqësuesish”) ka dhënë kontributin në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) pranë Grupit Ndërinstitucional dhe Teknik Ndërinstitucional të Punës dhe vijon të kontribuojë në takimet me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) për hartimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) dhe pas miratimit të PKEC do të kryejë përditësimin e planit ekzistues për emergjencat civile, siç edhe është lënë rekomandimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, raporti: “Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë” 01.01.2019-31.12.2021, nr. Prot 103/23. datë 01.11.2022.

Ministria e Arsimit dhe Sportit – Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë

- U përgatitën dhe u vendosën materiale figurative në mjediset e brendshme e të jashtme të institutit. Tematika e tyre lidhet me situatën e tërmetit, mbrojtjen nga Covid-19, masat mbrojtëse nga situatë gripale etj.
- U përgatit një rregullore e posaçme për mbrojtjen nga Covid-19. Në të janë përcaktuar detyra për punonjësit sipas sektorit, si dhe për nxënësit.
- U përgatit një plan veprimi për situatën gripale dhe virozat në prag dimri 2022-2023.
- Janë përcaktuar drejtimet hyrëse dhe dalëse të nxënësve në rast situatë emergjente. Kjo është shoqëruar me vendosje tabelash dhe sinjalistikë tjetër.
- Janë kontrolluar dhe janë në gatishmëri fikëset e zjarrit në të gjitha mjediset e shkollës dhe konviktit.
- U kryen punime për kanalizimet në mjediset e jashtme të shkollës e konviktit duke shmangur mundësinë e përmytjeve të mundshme.
- Janë kontrolluar depozitat e ujit për të shmangur ndonjë mundësi infeksioni masiv.
- Në planet edukative, janë përcaktuar e trajtuar tema specifike që lidhen me menaxhimin e situatave në raste tërmeti, mbrojtje nga gripi e virozat etj.

Ministria e Arsimit dhe Sportit – Instituti i Nxënësve që nuk shikojnë

- Në institucion vazhdimisht realizohet mirëmbajtja e ambjenteve të jashtme të institutit si pastrime kanalesh, mirëmbajtje tarrace e godine për të përjashtuar mundësinë e përmytjeve gjatë periudhës së shirave.
- Investime, trajnime dhe bashkëpunime janë realizuar në fushën e teknologjisë asistive për personat që nuk shikojnë, si bashkëpunimi me gjimnazet e Tiranës për regjistrimet në audio të librave.
- Në institucion është realizuar plani i evakuimit në raste tërmetesh dhe fatkeqësive të tjera natyrore. Nga personat përgjegjës janë realizuar trajnime për përdorimin e fikëseve të zjarrit.
- Personeli mjekësor, mjeku edhe infermieret janë në gjendje gatishmërie, për të përballuar rastet e virozave dhe gripeve te fëmijet dhe personeli shkollor.
- Aktualisht në institucion ka kapacitete administrative dhe teknike për të minimizuar riskun në lidhje me misionin e edukimit dhe mirërritjen e fëmijëve me probleme në shikim.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Referuar niveleve të reshjeve të shiut sipas Buletinit mbi Rreziqet Natyrore, është hartuar edhe manuali operacional i reagimit.

Hidrovorët; Kolektorët/Kanalet kryesore Kullues; Kanalet e Ujërave të Larta (KUL); Lumenj; Argjinaturat; Digat e rezervareve për ujitje:

-Vlerësohen pasojat nga prurjet e ujit;

-Zbatohen të gjitha punimet mirëmbajtëse/rehabilituese urgjente, që garantojnë funksionimin normal dhe sigurinë e tyre.

Sipërfaqe me prani uji: -Evidentimi në vazhdimësi i reduktimit të madhësisë së sipërfaqeve të përmytura.

Masat e përgjithshme:

-Informim mbi reduktimin e sipërfaqeve të përmytura;

-Nevojat për investime/shpenzime për rikthimin e infrastrukturës në kushtet e projektit.

Instituti i Shëndetit Publik: Janë përgatitur planet si më poshtë:

1. Emergjenca e COVID -19 dhe shtamet e reja qarkulluese: Plani strategjik i veprimit ndaj COVID -19.
2. Emergjenca e COVID -19 dhe shtamet e reja qarkulluese: Plani Kombëtar i Vaksinimit ndaj COVID -19.
3. Emergjenca e Gripit sezonal: Plani i përgatitjes ndaj gripit sezonal dhe virozave respiratore dhe vaksinimit ndaj gripit sezonal.
4. Emergjenca e rezistencës antimikrobike: Plani strategjik për rezistencën antimikrobike dheurvejancën e saj.
5. Emergjenca nukleare si pasojë e luftës në Ukrainë: Draft - Plani i mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga rreziqe nukleare.

6. Emergjenca nukleare si pasojë e luftës në Ukrainë: Draft - Plani i përgjigjes për rreziqet ndaj sëmundjeve infektive dhe vaksinimit për krizën e refugjatëve nga Ukraina.
7. Emergjenca e Lisë së Majmunit: Draft - Plani i përgjigjes ndaj Lisë së majmunit (MPX).
8. Emergjenca e Lisë së Majmunit: Draft - Plani i vaksinimit ndaj Lisë së majmunit (MPX).
9. Draft - Plani i përgjigjes ndaj parandalimit të sëmundjeve infektive gjatë përmbytjeve.
10. Rishikimi i planit të ruajtjes së vaksinave gjatë fatkeqësive natyrore.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: AMBU me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), në kuadër të projektit "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor", së bashku me grupin ndërinstitucional të punës, hartoi:

- Objektivat për Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet për zona me rrezikshmëri nga përmbytjet në basenin Drin-Bunë;
- Projekt-Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për një territor gjeografik të dedikuar të basenit ujqor ndërkufitar Drin-Bunë i karakterizuar nga përmbytje me pasoja domethënëse, i cili përfshin zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësisve administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës).
- Njëkohësisht, mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 91, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)" dhe Vendimit nr. 219 datë 11.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor", me ekspertizën e ofruar nga projekti, nëpërmjet GIZ, projekt-PMRP është plotësuar edhe me Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është pajisur me Deklaratën e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor në gusht 2022.

Paketa e plotë e akteve të mësipërme, së bashku me hartat e riskut të krijuara për këto zona, pas marrjes së bashkërendimit të punës me institucionet përbërëse të KKKU-së dhe reflektimit të sugjerimeve dhe mendimeve, është dërguar në KKKU për miratim, pas të cilit dokumenti do t'i nënshtrohet periudhës 6-mujore të konsultimit me publikun dhe me institucionet respektive të Malit të Zi (territori që përfshin plani është pjesë e basenit ujqor ndërkufitar Drin-Bunë).

- Me mbështetjen e projektit "Menaxhimi i integruar i rrezikut nga përmbytjet ndërkufitare në basenin e lumit Drin" UNDP Adaptation Fund, është vijuar procesi i krijimit të hartave të rrezikut nga përmbytjet për 5 (pesë) nga 8 (tetë) zonat e basenit Drin-Bunë. Konkretisht, nga projekti është kryer Geodetic Surveying of the Riverbed of Drin River (28 urave dhe 1 argjinature);
- Janë realizuar procese për krijimin e hartave të riskut nga përmbytjet për zonat e identifikuar me rrezik nga përmbytjet për basenet Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe hartimi i Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për këto territore (nëpërmjet Eastern Balkans Investment Framework EBIF).

5. Sistemet e monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit

Ministria e Arsimit dhe Sportit: Në kuadër të mbrojtjes civile MAS ka marrë pjesë në takimet me struktura të AKMC dhe ka dërguar informacion sipas analizës SWOT lidhur me riskun e tërmetit, biologjik, përmytjet dhe rrëshqitjet e dheut. Gjithashtu bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 është parashikuar (pika A 2.5) edukimi mbi reagimin ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore dhe është përgatitur moduli “Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Në infrastrukturën e kullimit, monitorimi është për sistemet e kullimit me ngritje mekanike, që kanë për referencë nivelin e ujit në hyrje të hidrovorëve (pra nivelet normale dhe nivelet maksimale, përtej të cilit fillon edhe përmytja në tokat bujqësore).

Instituti i Shëndetit Publik: Mbi sistemet e monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë ju bëjmë me dije si më poshtë:

Është tërësisht funksional sistemi i survejancës, monitorimit, lajmërimit të hershëm për semundjet infektive, sindromat e rëndësishme, Alert dhe zbulimin e ngjarjeve me rëndësi të veçantë.

Ky sistem është tërësisht i dixhitalizuar dhe përfshin survejancën, monitorimin dhe lajmërimin e sëmundjeve infektive, lajmërimin e hershëm të alarmeve dhe ngjarjeve të veçanta, sistemin e inteligjencës epidemike ku përfshihen monitorime të shtypit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, survejancën e ALERT, sindromike etj. Sistemi është i shtrirë në të gjithë vendin si dhe në zonat ndërkufitare.

6. Gjendja ekzistuese e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare për zvogëlimin e riskut

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Në lidhje me kërkesën për kapacitetet administrative, teknike dhe financiare për zvogëlimin e riskut konfirmon ekzistencën e kapaciteteve në këtë drejtim, lidhur me misionin e tyre.

Ministria e Arsimit dhe Sportit: MAS ka në strukturën e saj sektorin e Emergjencave Civile. Gjithashtu në funksion të misionit të saj MAS ofron mësimdhënie në distancë nëpërmjet platformave digjitale Academia.al dhe kanalit televiziv "RTSH shkollë", në rastin e situatave të paparashikueshme si pandemia apo fatkeqësi natyrore. Në godnën e MAS ekzistojnë të instaluar mjete teknike si sensor për zjarrin dhe fikse zjarri.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur tregues të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe gjendja ekzistuese e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të 4 Drejtorive Rajonale të Ujitjes dhe të Kullimit Lezhë (për qarqet Lezhë, Shkodër dhe Kukës), Durrës (për qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër), Fier (për qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë), Korçë (për qarqet Berat, Elbasan dhe Korçë).

DUK	Personel	Eskavator krahëgjatë	Draga	Automjete/ Rimorkjat- or	Hidrovorë	Argjinatua /KUL (km)	Kanale kulluese (km)	Kanale ujitëse (km)	Rezervuar
-----	----------	-------------------------	-------	--------------------------------	-----------	----------------------------	----------------------------	---------------------------	-----------

Durrës	60	4	1	3	3	103	328	185	1
Fier	143	10	2	1	13	391	1038	412	3
Korçë	41	4	0	4	2	128	431	299	2
Lezhë	106	7	1	3	9	168	1619	331	1
Shuma	350	25	4	11	27	790	3416	1227	7

Lidhur me infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja, buxheti i përdorur përgjatë vitit 2022 është 593,115,512 lekë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 ka nisur procedura për implementimin e 2 (dy) projekteve të mëdha për rehabilitimin e plotë të hidrovorit të Karavastasë në Divjakë (me vlerë të plotë 267 milionë lekë), që përfundon gjatë vitit 2023 dhe të rehabilitimit të hidrovorit të Akërnisë (me vlerë të plotë 148 milionë lekë), ku punimet shtrihen në dy vite 2022-2023.

Instituti i Shëndetit Publik: Ekzistojnë kapacitetet administrative, teknike dhe financiare për zvogëlimin e riskut, lidhur me misionin e tyre.

❖ Investimet e AKMC- Fonde të deleguara

Pas miratimit të Rregullores së Shpërndarjes së Fondit për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore dhe realizimit të analizës së detajuar të projekteve të përcjella nga subjektet aplikuese, në total 25 (njëzet e pesë) konstatohet se: Nga diferenca e fondit total për investime infrastrukturore për vitin 2022 (600,000,000 lekë) dhe vlerës së nevojshme të projekteve në zbatim (142,598,788 lekë), është realizuar vlerësimi total i 13 projekteve me vlerë 489,464,113 lekë. Të deleguara në bashkitë: Lushnje, Fier, Pustec, Dimal, Konispol, Skrapar, Maliq, Korçë, Roskovec, Divjakë, Malësi e Madhe, Peqin. Vërehet se 10/13 projektet e përcjella për financim i dedikohen investimeve për mbrojtjen nga përmbytja.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, referuar dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, ka trajtuar dokumentacionin që gjeneron masën kompensuese për përmbytjet, djegiet, tërmetet dhe rrëshqitjet e tokës nga viti 2016 deri më 2019.

Dosje të vlerësuara në total janë 2591 me vlerë detyrimi sipas trajtimit të realizuar 314,156,130.84 lekë.

❖ Humbjet nga fatkeqësitë

- Ngjarje të shkaktuara nga tërmetet ose premisa për ndodhjen e tyre.

Gjatë vitit 2022 Instituti i Gjeoshkencës, Ujit dhe Mjedisit ka regjistruar një numër të madh lëkundjesh të tërmeteve, por vlen të theksojmë 42 prej tyre, me magnitudë nga 2.7 deri në 5.6 të shkallës Richter.

Nga informacionet e marra gjatë vitit 2022, u raportuan banesa të dëmtuara: Qarku Korçë 245, Qarku Kukës (kryesisht bashkia Tropojë 30), Qarku Shkodër (kryesisht bashkia Pukë) 23 banesa dhe 25 oxhaqe.

- Situatat e shkaktuara si pasojë e kushteve atmosferike.

- *Nga reshjet e dëborës:*

Problematika në akse rrugore të ndryshme të vendit, gjatë periudhës janar – shkurt 2022, Qarqet më të prekura kanë qenë Dibra, Kukësi, Korça, Gjirokastra dhe Shkodra. Situatat e krijuara nga reshjet e dëborës janë vënë nën kontroll dhe nuk kanë shkaktuar problematika serioze në qarkullimin e mjeteve.

- *Nga reshjet e breshrit:*

Gjatë muajit maj, në Qarkun Korçë, Bashkia Maliq, janë shkaktuar dëme në disa kultura bujqësore.

- *Nga reshjet e shiut:*

Në qershor 2022, Bashkia Kuçovë janë dëmtuar 3 banesa si pasojë e reshjeve të shiut, në të cilat niveli i ujit arriti mbi 80 cm.

Gjatë muajit shtator, si pasojë e reshjeve të shiut, janë hasur problematika në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër. Këto reshje kanë sjellë vërshimin e përrrenjve malorë, të cilat krijuan probleme të konsiderueshme veçanërisht në bashkitë Shkodër, Vau – Dejës, Dibër, Klos, Tropojë dhe në rrugët nacionale të bashkive Pukë dhe Fushë Arrëz dhe konkretisht si më poshtë.

Qarku Shkodër:

- U përmbytën 71 shtëpi dhe u mbytën 40 krerë dele dhe një numër i konsiderueshëm shpendësh.
- U shkatëruan 2 ura, 1 kanal vaditës në gjatësinë 1 km, çatia e shkollës 9-vjeçare në fshatin Gjogjan, Bashkia Pukë, rrëshqitje në digën e rezervuarit në qytetin e Pukës.
- Në bashkinë Shkodër u bllokuan të gjitha rrugët e qytetit dhe u përmbytën biznese dhe garazhe.
- Rrëshqitje dherash dhe dëmtim të shumë akseve rrugore rurale dhe kanaleve vaditëse dhe kulluese.

Qarku Dibër:

Në Bashkinë Dibër ka pasur rrëshqitje të dherave dhe rënie gurësh në akset Lurë -Kurbnesh dhe Pregj Lurë-Lurë Muhurr-Reç, ndërsa në Bashkinë Klos në disa rrugë rurale të Njësisë Administrative Xibër, ka pasur gërryerje të rrugëve dhe rënie gurësh, si dhe inertesh.

Qarku Kukës:

- Në Bashkinë Tropojë janë shkaktuar dëme në infrastrukturën rrugore, banesa, sipërfaqe bujqësore, gjënë e gjallë, rrjetin elektrik dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve, çarje e kurorës së rezervuarit në fshatin Zherkë, dëmtim i Nënstacionit elektrik në Gropë Fierzë, u evidentuan 10 ura të dëmtuara.

Gjatë muajit nëntor prej datës 20 deri në datën 23, territori i Shqipërisë u përfshi nga reshje të shumta shiu dhe si rezultat u përball me një valë përmbytjesh, kryesisht në rajonin veri-perëndimor të vendit. Qarqet më të prekura ishin Shkodra dhe Lezha.

- Dëmtimet në infrastrukturë kanë qenë si më poshtë:

- 4 ura të dëmtuara, 2 ujësjellës (Oblika 1 dhe 2) në bashkinë Shkodër, dolën përkohësisht jashtë funksionit, 31 km rrugë rurale të dëmtuara,

Për përballimin e situatës janë angazhuar 640 Forca te Armatosura, 565 Forca Zjarrfikëse, 454 Forca nga Policia Shtetit, 345 Forca Vullnetare, 126 Forca të FNSH, Ekipet e Shërbimit Mjekësor, 135 mjete të kalueshmërisë së lartë dhe zjarrfikëse dhe 16 motobarka.

Dëmet e shënuara në momentin e vërshimeve maksimale të ujërave sipas bashkive kanë qenë:

- Bashkia Shkodër, 2585 ha të përmbytura, 36 familje të evakuuar, 159 persona të evakuuar, 590 banesa prezencë uji, 560 abonente pa energji dhe u pezullua mësimi në 27 shkolla.
- Bashkia Vau Dejës, 1711 ha të përmbytura dhe 10 banesa me prezencë uji.
- Bashkia Malësi e Madhe 50 ha sipërfaqe e përmbytur dhe 2 banesa prezencë uji.
- Bashkia Lezhë, 1300 ha të përmbytura dhe 24 banesa me prezencë uji.
- Bashkia Kruje, rreth 150 ha të përmbytura.
- Bashkia Durrës, 8 banesa me prezencë uji.

Në datën 11 dhe 12 dhjetor vendi është përfshirë nga reshje të dendura shiu, të cilat kanë shkaktuar dëme dhe problematika në disa qarqe dhe bashki.


Dëmet e shënuara në momentin e vërshimeve maksimale sipas bashkive kanë qenë:

- Përmbytje e tokave bujqësore në bashkitë: Lezhë 440 ha, Shkodër 500 ha, Krujë 100 ha, Durrës 300 ha.
 - Situata për shkak të zjarreve

Gjatë vitit 2022 në të gjithë vendin janë raportuar 1386 vatra zjarri nga të cilat 241 prej tyre në ambiente banimi dhe biznesi, të cilat përbëjnë 17% të numrit të përgjithshëm të zjarreve. Nga raportimet rezulton se këto vatra kanë qenë në 61 bashki. Prefekturat më të prekura kanë qenë Vlora, Fieri dhe Shkodra, të cilat zënë 51% të numrit total të vatrave të zjarrit.

Si pasojë e zjarreve në banesa, fatkeqësisht kemi patur 10 humbje jete, përkatësisht në bashkitë Vlorë 1, Korçë 1, Himarë 2, Kamëz 1, Patos 1, Divjakë 1, Sarandë 1, Tiranë 1 (foshnjë 6 muajsh) dhe Kukës 1 humbje jete. Sa i takon dëmeve materiale janë dëmtuar 241 ndërtesa.

Forcat e angazhuara në nivel vendor dhe qendror për përballimin e situatave të krijuara nga zjarret gjatë vitit, janë si më poshtë:



❖ PROBLEMATIKA

Krahas punës së bërë për parandalimin, zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, përgatitjen dhe kryerjen e operacioneve për përballimin e situatave gjatë vitit 2022 ka pasur edhe problematika, të cilat do të jenë në fokus gjatë vitit 2023. Problematikat kryesore:

- Moszbatimi i “Parimit të subsidiaritetit” në koordinimin në nivel qarku për përdorimin e kapaciteteve që disponojnë strukturat e vetëqeverisjes vendore sipas nenit 7, të Ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe mungesë sensibilizimi të popullatës;
- Planet e masave të hartuara nga njësitë e qeverisjes vendore për parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, nuk gjejnë zbatim konkret;
- Mungesa e planifikimit dhe përdorimit të fondeve të emergjencave civile nga institucionet publike qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore si detyrim ligjor;
- Pamjaftueshmëria e mjeteve dhe burimeve njerëzore e teknike nga MZSH-të e bashkive, strukturat e pyjeve dhe të AKZM;
- Mossigurimi nga bashkitë i pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për vullnetarët/komunitetin që angazhohet në operacionet e emergjencave civile;
- Institucionet qendrore, kryesisht ministritë e linjës, tejkalojnë afatin maksimal të korrespondencës zyrtare me AKMC;
- Mungesa e flotës ajrore për ndërhyrje operationale nga ajri për fikjen e zjarreve masive, në pyje, kullota, objekte të rëndësishme të veçantë, etj;
- Nevoja për ushtrime, trajnime, veçanërisht për personelin operacional i cili merr pjesë në shuarjen e zjarreve në pyje dhe operacionet e dhënies së ndihmës në rast përmbytjesh;
- Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, infrastrukturës, djegiet e pakontrolluara, masat dhe pasojat që sjell si veprim;
- Mungesa e inspektimeve dhe mospërgatitja e raporteve përkatëse për masat parandaluese, zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive, ngjarjet emergjente të ndodhura dhe problematika të tjera, të vërejtura apo të raportuara nga institucionet qendrore dhe vendore. Kjo për shkak të mosplotësimit të Sektorit të Inspektimit me burime njerëzore sipas strukturës organike.

Ky Raport i konceptuar në nivel makro shërben për një planifikimi efektiv afatmesëm në nivel politik dhe financiar të objektivave të çdo institucioni në përgjegjësinë e të cilit janë çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, duke risjellë në fokus domosdoshmërinë e integritetit të menaxhimit të riskut në vendimmarje.

Duke ju falënderuar,

Konceptoi: A.Bala
2K/datë: 27.02.2023

A. Bala



Rruga “Skënderbej”, Blloku i Ambasadave, Tiranë